

*Specialist në Sektorin e Infrastrukturës së Sistemeve CORS, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.*

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 04 datë 08.01.2024, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Infrastrukturës së Sistemeve CORS, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

1. Zbatimin dhe kontrollin e të gjitha punimeve që lidhen me evidentimin, zyrtarizimin dhe zbatimin e standardeve të BE në krijimin, mbledhjen, ruajtjen, përditësimin dhe aksesimin me të dhëna të përfshira në të gjitha temat që parashikohen në pikën 2, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2012 dhe VKM nr. 669/2013 që lidhen me Kornizën referuese Gjeodezike;
2. Përgatitjen e punës për mirëmbajtjen e infrastrukturës së sistemit ALBCORS (GNSS) me qëllim ofrimin e shërbimit të përdorimit të metodave të pozicionimit global në kohë reale (RTK) dhe pas procesimit të matjeve (PP);
3. Njohjen dhe mirëmbajtjen e programeve të posaçme të qendrës së kontrollit të sistemit ALBCORS (Geo++), stacioneve mareografike (hydras3) si dhe azhornimin dhe përmirësimin duke mbajtur lidhje të ngushtë me kompanitë përkatëse të lëvrimin të tyre;
4. Organizimin e punës në zbatim të urdhrave të Përgjeggjesit të Sektorit në zbatim të ligjit nr. 72/2012 dhe akteve të tij, në funksion të mbajtjes në efikasitet të sistemit gjeodezik aktiv ALBCORS në lidhje me ruajtjen e të dhënave, saktësinë dhe metodologjinë e llogaritjes së pikave të sistemit;
5. Monitorimin, identifikimin dhe asistimin e të gjithë përdoruesve të sistemit ALBCORS nëpërmjet aksesimit të të dhënave bazë në varësi të teknologjisë së aplikuar në sistemet marrës dhe dhënës;
6. Krijimin e strukturës së të dhënave nga sistemet aktive, grumbullimin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre historike;

7. Përgatitjen e punës për mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjetit gjeodezik mareografik me qëllim ofrimin e të dhënave për matjen e nivelit mesatar të detit;
8. Identifikimin e nevojave dhe propozimin e protokolleve teknike, ndryshimeve ligjore, rregulloreve, urdhëresave që lidhen me funksionimin e sistemit ALBCORS dhe rregullimin e marrdhënieve me përdoruesit e sistemit;
9. Mirëmbajtjen dhe azhurnimin e teknologjisë së aplikuar në sistemin qendror dhe stacionet bazë të ALBCORS si dhe pjesëmarrjen në certifikimin e sistemeve alternative të CORS nga autoritete publike/ private, sipas përcaktimeve në rregulloret/ manualët përkatëse të miratuara;
10. Koordinimin e punës me sektorët e drejtorisë (KRGJSH) së vartësisë për politikat e investimeve dhe prespektive të sistemit ALBCORS (EPN dhe EUREF);
11. Monitorimin, mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e sistemit ALBCORS;
12. Sigurimin e shërbimit dhe aksesimit të sistemit ALBCORS, nga përdoruesit nëpërmjet një sigurie teknike, shkencore dhe eksperiencë të pandërprerë;
13. Menaxhimin, strukturimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave që gjenerojnë vetë sistemet gjeodezike aktive, si dhe çdo produkt tjetër lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon sektori;
14. Zbatimin e procedurave dhe protokolleve teknike të teknologjisë së aplikuar në sistemin qendror të menaxhimit të sistemit gjeodezik aktiv ALBCORS dhe mareografik;
15. Kryerjen e çdo funksioni të ngarkuar nga eprori, për realizimin e veprimtarisë së sektorit dhe ASIG.
16. Mirëmbajtjen në gjendje pune të vazhdueshme të sistemin e hardware-ve dhe software-ve sipas teknologjisë së aplikuar në qendër dhe në stacione, (27 stacione ALBCORS dhe 4 stacione mareografike) në bashkëpunim me sektorin e IT;
17. Propozimin për përmirësimin e teknologjisë dhe software-ve për sistemin qendror dhe stacioneve;
18. Bashkërendimin e veprimeve dhe nismave të autoriteteve publike në fushën e informacionit të rrjeteve gjeodezike aktive sipas udhëzimeve të eprorit;
19. Përfaqësimin e institucionit në takime pune dhe konferenca lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon sektori, sipas propozimit të Drejtorit të Drejtorisë dhe miratim të Drejtorit të Përgjithshëm.

## **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

1. Të këtë mbaruar studimet e larta e të zotërojë diplomë “Master profesional” në një nga këto profile: Gjeodezi/Gjeoinformatikë/Informatikë/Teknologji informacioni;
2. Të këtë përvojë pune 1 vit në fushën përkatëse;
3. Të zotërojë njohuri të gjëra të fushës gjeodezisë dhe gjeoinformacionit, të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të

- dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre;
4. Të ketë njohuri të thelluara për rrjetet gjeodezike, veçanërisht atyre të sistemit aktiv dhe mareografike në nivel kombëtar, sipas përcaktimit në ligjin nr. 72/2012 dhe VKM-së nr. 669/2013;
  5. Të ketë njohuri dhe eksperiencë në gjuhë programimi C++, Java (etj) si dhe sistem operimi Linux;
  6. Të njohë mirë gjuhën angleze, edhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet;
  7. Të ketë njohuri të thelluara teorike dhe praktike në Gjeodezi lidhur me projeksionet e ndryshme ndërkombëtare hartografike dhe veçanërisht UTM, TMzn, Gaus-Kryger et.;
  8. Të ketë njohuri mbi sistemet e pozicionimit global (GPS, GLONAS, GALILEO ...), EUPOS, CORS, rrjetet e EPN dhe EUREF;
  9. Të njohë programet e sistemeve të pozicionimit Global dhe metodat e matjeve RTK dhe PP (post procesing);
  10. Të ketë njohuri kompjuterike bazë dhe ato të avancuara si: AutoCAD, ArcGIS Desktop, Quantum GIS, Openlayers, Mapserver, Word, Excel and Access;
  11. Të ketë njohuri të thelluara teorike lidhur me transformimin e informacionit hartografik në referenca gjeodezike te ndryshme;
  12. Të zotërojë njohuri të legjislacionit shqiptar në fushën e informacionit gjeohapësinor;
  13. Të zotërojë aftësi të mira komunikimi, propozim dhe menaxhim projektesh si dhe aftësi të mira raportimi, aftësi për të suportuar kryerjen e punimeve gjeodezike me standarde të nivelit që kërkon integrimi europian i vendit, aftësi për të menaxhuar një grup ose grupe ekspertësh dhe aftësi për të qënë lider i grupit;
  14. Kandidati duhet të jenë krijues në lidhje me zhvillimin në përputhje me standardet europiane të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË ( IV-1 )**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 15.08.2024, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit [burime.njerezore@asig.gov.al](mailto:burime.njerezore@asig.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore

- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t'u kontaktuar.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.

Pas datës 15.08.2024, aplikantët të cilët kalojnë fazën e parë të vlerësimit, do të njoftohen me e-mail për datën dhe orën e zhvillimit të intervistës.